

Vendim nr. 225, datë 01.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese
Ilir Toska, Anëtar
Genti Ibrahim, Anëtar

në datën 01.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (F) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **FAIK BUCI, SHKËLZEN BUCI**, përfaqësuar nga avokati Sokol Tahiraj, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 375, datë 17.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1108, datë 16.11.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2025-1581, datë 16.10.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 5, 17, 27, 30, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Faik Buci (*kërkuesi i parë*) është babai i kërkuesit Shkëlzen Buci (*kërkuesi i dytë*). Ata janë proceduar penalisht për vrasjen e familjares së tyre, përkatësisht vajzës së kërkuesit të parë dhe motrës së kërkuesit të dytë, të moshës 23 vjeç, ngjarje e ndodhur në vitin 2012. Autorësia e veprës penale mbeti e pazbardhur për disa vite, për shkak të mosidentifikimit të viktimës dhe të autorëve.

2. Më 14.09.2012, në vendin e quajtur Mali i Fagut, Komuna Shëngjergj, Tiranë, një shtetas që kishte dalë për gjueti ka gjetur rastësisht eshtra njerëzore të skeletizuara. Në vijim, më 21.09.2012, gjatë kontrollit të zonës me një qen të trajnuar, janë gjetur edhe pjesë të tjera skeletore, flokë dhe veshje pjesërisht të djegura. Sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor të vitit 2012, eshtrat i përkisnin një personi të gjinisë femërore, rreth 30 vjeç, ndërsa koha e mundshme e vdekjes ishte vlerësuar të kishte ndodhur disa muaj deri në dy vjet përpara gjetjes së tyre. Për shkak të gjendjes së mbetjeve skeletore, shkaku i vdekjes nuk kishte mundur të përcaktohej. Meqenëse nuk ishte bërë i mundur identifikimi i viktimës dhe i autorëve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 25.01.2013, ka vendosur pezullimin e procedimit penal nr. 4562 për veprën penale të vrasjes me dashje, të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal (KP).

3. Në datën 17.01.2018, një shtetas i arrestuar në kuadër të një procedimi tjetër penal, gjatë deklarimeve të tij, ka shprehur dëshirën për të bashkëpunuar me drejtësinë, duke nënshkruar marrëveshjen përkatëse. Në vijim, ai ka deklaruar se kishte pasur shoqëri me kërkuesin Shkëlzen Buci dhe se rreth pesë ose gjashtë vjet më parë kishte qenë dëshmitar okular i vrasjes së motrës së këtij të fundit. Sipas deklarimeve të tij, kërkuesi Shkëlzen Buci, pasi e kishte marrë motrën me automjetin e deklaruesit dhe e kishte çuar në vendin e ngjarjes, e kishte qëlluar atë me armë zjarri, të llojit “pistoletë”.

4. Në këto rrethana, me vendimin e datës 02.02.2018, është vendosur rifillimi i procedimit penal nr. 4562 të vitit 2012. Në kuadër të hetimeve janë kryer verifikime në terren mbi itinerarin e treguar nga dëshmitari okular, si dhe janë urdhëruar ekspertime të reja biologjike e mjeko-ligjore, përfshirë analizën e plotë të ADN-së. Nga rezultatet e këtyre ekspertimeve ka rezultuar se: (i) eshtrat i përkisnin një personi të gjinisë femërore; (ii) profili i ADN-së i përfutur nga eshtrat paraqiste lidhje biologjike nënë-bijë me ADN-në e bashkëshortes së kërkuesit të parë dhe nënës së kërkuesit të dytë, çka ka bërë të mundur identifikimin përfundimtar të viktimës. Sipas deklarimeve të dëshmitarit okular, motivi i vrasjes lidhej me refuzimin e viktimës për t’iu nënshtruar një fejeje të detyruar, për shkak të së cilës ajo ishte vazhdimisht nën presion dhe kërcënime nga familjarët e saj. Sipas të njëjtave

deklarime, pas debateve të vazhdueshme, viktimë është qëlluar me armë zjarri nga vëllai i saj, kërkuesi Shkëlzen Buci, ndërsa ai dhe i ati i tij, kërkuesi Faik Buci, e kanë kërcënuar dëshmitarin okular që të mos tregonte për ngjarjen.

5. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori ka akuzuar kërkuesin Faik Buci për kryerjen e veprave penale të vrasjes me paramendim, të kryer në bashkëpunim, dhe të mbajtjes pa leje të armëve të ftohta, ndërsa kërkuesin Shkëlzen Buci për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 78, 25 dhe 279 të KP-së. Më pas, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar kërkesën e prokurorit për dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të kërkuesve, sipas akuzave të ngritura.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 375, datë 17.02.2022, ka vendosur: (i) për kërkuesin Faik Buci deklarimin fajtor për veprën penale të vrasjes me paramendim, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 25 dhe 78 të KP-së, duke e dënuar me 25 vjet burgim, si dhe për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve të ftohta, të parashikuar nga neni 279 i KP-së, duke e dënuar me 1 vit burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, gjykata ka bërë bashkimin e dënimeve dhe ka caktuar një dënim të vetëm prej 25 vjetësh burgim, vuajtja e të cilit fillonte nga data 04.09.2020; (ii) për kërkuesin Shkëlzen Buci, deklarimin fajtor për veprën penale të vrasjes me paramendim, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 25 dhe 78 të KP-së, duke e dënuar me 25 vjet burgim, vuajtja e të cilit fillonte nga data 05.09.2020.

7. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kërkuesit kanë paraqitur apel, por gjykata e apelit, me vendimin nr. 1108, datë 16.11.2022, ka vendosur lënien në fuqi të tij. Më pas, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1581, datë 16.10.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të tyre, me arsyetimin se ai nuk ngrinte asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

8. Kërkuesit, të cilët aktualisht vuajnë dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Reç, Shkodër, të përfaqësuar nga mbrojtësi i tyre, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 04.05.2026.

II

Pretendimet e kërkuesve

9. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmblodhur, kanë pretenduar se nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara u janë cenuar:

9.1.E drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 të Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 9.1.1. *E drejta për gjykim të drejtë*, pasi nuk janë respektuar standardet kushtetuese të një procesi të drejtë, të paanshëm dhe të bazuar në prova të ligjshme. Vendimet gjyqësore janë mbështetur në prova që nuk përmbushin kriteret e ligjshmërisë dhe të besueshmërisë procedurale dhe se fajësia nuk është provuar mbi prova të administruara në përputhje me ligjin.
- 9.1.2. *Parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve*, pasi kërkuesit nuk kanë pasur mundësi reale dhe efektive për të kundërshtuar provat e akuzës dhe për të ushtruar të drejtat procedurale në kushte të barabarta me organin e akuzës.
- 9.1.3. *E drejta e mbrojtjes*, pasi nuk është garantuar e drejta për të pyetur dhe për të ballafaquar dëshmitarët e akuzës, duke cenuar një element thelbësor të procesit të rregullt ligjor.
- 9.1.4. *Parimi i sigurisë juridike*, për shkak të mosrespektimit të standardeve procedurale të provës.
- 9.1.5. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë nxjerrë përgjegjësinë penale pa ekzistuar prova të drejtpërdrejta që t'i lidhnin ata me veprën penale, duke u mbështetur kryesisht në rrethana dhe lidhje indirekte. Gjykatat e zakonshme nuk kanë kryer analizë të plotë dhe të balancuar të provave dhe të pretendimeve të palëve, duke mos përmbushur standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve.

9.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në marrjen e vendimit nuk kanë respektuar standardin “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, duke transferuar në mënyrë të tërthortë barrën e provës te kërkuesit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesve

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi

gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kriteret paraprake të legjitimitimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbyllja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë, si pasojë, moskalimin e saj në seancë plenare.

12. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson të ndalet në analizën e legjitimitimit *ratione materiae*, që ka të bëjë me natyrën kushtetuese të pretendimeve. Në këtë drejtim, kërkuuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për gjykim të drejtë, parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, së drejtës për t'u mbrojtur, parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsytimit, si dhe cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

13. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë, parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, së drejtës për t'u mbrojtur dhe parimit të sigurisë juridike, kërkuuesit, në thelb, kanë parashtruar të njëjtat argumente. Më konkretisht, argumentet e tyre lidhen me vendimin dhe procedurën për sigurimin e provës (dëshminë e dëshmitarit okular), për të cilin, sipas tyre, gjykata e shkallës së parë kishte disponuar në dhomën e këshillimit në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe se nuk kanë pasur mundësi reale dhe efektive për ta kundërshtuar atë.

14. Për këto pretendime, Kolegji konstaton se kërkuuesit i kanë ngritur ato si në ankimin drejtuar gjykatës së apelit, ashtu edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Këto pretendime kanë marrë përgjigje të arsyetuara nga të dyja gjykatat, të cilat kanë dhënë shkaqe të mjaftueshme se përse ato nuk qëndronin. Konkretisht, gjykata e apelit ka vlerësuar se: (i) gjykata e shkallës së parë ka respektuar kërkesat e neneve 320-321 të KPP-së për sigurimin e provës; (ii) në seancën për marrjen e dëshmisë së dëshmitarit okular, në kuadër të sigurimit të provës, ka qenë i pranishëm mbrojtësi i kërkuësve, i cili ka ushtruar të drejtën për t'i drejtuar pyetje dëshmitarit; (iii) vendimi për sigurimin e provës është shqyrtuar mbi bazën e ankimit të veçantë të kërkuësve dhe është lënë në fuqi nga gjykata e apelit me vendimin nr. 72, datë

21.01.2021. Në të njëjtën linjë, edhe Gjykata e Lartë ka vlerësuar se shkaqet e parashtruara në rekurs për këtë çështje kishin marrë përgjigje nga gjykata e apelit.

15. Për sa më lart, Kolegji vëren se kërkuessve u është garantuar mundësia që, përmes mbrojtësit të tyre, të marrin pjesë në seancën e marrjes së dëshmisë, t'i drejtonin pyetje dëshmitarit dhe të kundërshtojnë gjyqësisht vendimin për sigurimin e provës. Në këto rrethana, interpretimi dhe zbatimi nga gjykatat e zakonshme të rregullave procedurale për sigurimin e provës nuk paraqitet haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar, ndërsa argumentet e kërkuessve nuk janë të tilla që të ngrenë dyshime për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë, parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, së drejtës për t'u mbrojtur dhe parimit të sigurisë juridike. Për rrjedhojë, këto pretendime janë haptazi të pabazuara.

16. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të prezumimit të pafajësisë, kërkuessit kanë parashtruar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë bazuar vendimet e tyre përgjithësisht në prova të tërthorta, pa ekzistuar prova të drejtpërdrejta që t'i lidhin me kryerjen e veprës penale. Sipas tyre, gjykatat nuk kanë kryer një analizë të plotë dhe të balancuar të provave të administruara dhe të pretendimeve të palëve, duke mos përmbushur standardin kushtetues të arsytimit të vendimeve gjyqësore dhe duke i deklaruar fajtorë pa u provuar fajësia e tyre përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Për shkak të lidhjes së ngushtë ndërmjet tyre, Kolegji do t'i shqyrtojë këto pretendime së bashku.

17. Kushtetuta në nenin 30 të saj përcakton se kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim kushtetues ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 4 të KPP-së, i cili përcakton gjithashtu se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se, sipas këtij parimi, në gjykimin penal, barra e provës i takon palës akuzuese, çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe gjykatat e zakonshme duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas këtij parimi, asnjë dënim penal nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 8, datë 20.02.2024; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata ka pohuar se për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave kushtetuese, ajo i referohet arsytimit të vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, ajo (Gjykata) është mjete i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata është shprehur gjithashtu se ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyr në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm

është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën thellësisht të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë pretendimet e kërkuesve, Kolegji do të verifikojë, së pari, nëse në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuesve gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë respektuar garancitë procedurale të parimit të prezumimit të pafajësisë, në veçanti për sa i përket barrës së provës dhe, së dyti, nëse vendimet e tyre kanë respektuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në këtë drejtim, Kolegji do të vlerësojë nëse gjykatat u kanë dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të kërkuesve dhe nëse arsyetimi i vendimeve të kundërshtuara paraqet gabime të dukshme ose elemente arbitrariteti, të një shkalle të tillë që e bëjnë procesin të padrejtë në aspektin kushtetues.

20. Në këtë këndvështrim, Kolegji vëren se procedimi penal i pezulluar në vitin 2013 ka rifilluar pas deklarimeve të dëshmitarit okular, i cili ka dhënë informacion mbi rrethanat e vrasjes së vajzës së kërkuesit të parë dhe motrës së kërkuesit të dytë. Në përfundim të hetimeve, të dy kërkuesit janë akuzuar për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim, të kryer në bashkëpunim, ndërsa kërkuesi Faik Buci edhe për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve të ftohta. Në përfundim të gjyimit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur deklarinin fajtor të të dy kërkuesve për veprën penale të vrasjes me paramendim, duke i dënuar secilin me 25 vjet burgim, ndërsa kërkuesin Faik Buci edhe për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve të ftohta. Gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur përfundimin për fajësinë e kërkuesve në një vlerësim tërësor të provave të administruara gjatë gjyimit, ndër të cilat bënte pjesë edhe dëshmia e këtij dëshmitari, pa u bazuar ekskluzivisht në të. Në arsyetimin e saj, ajo gjykatë ka analizuar motivin e vrasjes, rolin e secilit prej kërkuesve dhe ka arritur në përfundimin se kërkuesi Shkëlzen Buci ishte autori i drejtpërdrejtë i vrasjes, ndërsa kërkuesi Faik Buci kishte bashkëpunuar në kryerjen e saj. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, gjykata është mbështetur në në dëshminë e dëshmitarit okular, aktet e ekspertimit të ADN-së, të cilat kishin bërë të mundur identifikimin e viktimës, aktet mjeko-ligjore, deklarinet e familjarëve, si dhe prova të tjera rrethanoë që, sipas vlerësimit të saj, konfirmonin ekzistencën e konfliktit familjar dhe mbështesnin versionin e dhënë nga dëshmitari. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë e ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit okular si të detajuar, të qëndrueshme dhe të mbështetur nga provat e tjera të administruara në gjykim.

21. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka shqyrtuar edhe pretendimet e kërkuesve për pavlefshmërinë e procedurës së sigurimit të provës, cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe pavlefshmërinë e dëshmisë së

dëshmitarit okular, duke sqaruar gjithashtu statusin e tij, në këtë procedim, si dëshmitar dhe jo si bashkëpunëtor i drejtësisë. Për sa i takon vlerësimin e provave, gjykata e apelit ka arsyetuar se dëshmia e tij përmbante detaje të verifikuara gjatë hetimit, se vendndodhja e eshtrave përputhej me rrëfimin e tij, se ekspertimi i ADN-së konfirmonte identitetin e viktimës, ndërsa deklarimet e një dëshmitareje tjetër (motra e viktimës, njëherazi vajza e kërkuarit të parë dhe motra e kërkuarit të dytë) mbështesnin ekzistencën e konfliktit familjar dhe motivin e vrasjes. Gjykata e apelit ka çmuar gjithashtu se tërësia e provave të administruara konfirmonin bashkëpunimin e kërkuarve në kryerjen e veprës penale. Ndërsa Gjykata e Lartë, duke shqyrtuar rekursin e kërkuarve, ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në to përbënin kundërshtime të përgjithshme ndaj mënyrës së vlerësimit të fakteve dhe të provave nga gjykatat e faktit, pa argumentuar ekzistencën e ndonjërit prej shkaqeve të rekursit të parashikuara në nenin 432, pika 1, të KPP-së. Në këtë drejtim, ajo ka theksuar se rekursi nuk përbën mjet për rivlerësimin e provave ose për rishqyrtimin e çështjes së fajësisë së të pandehurve, pasi këto janë çështje që i përkasin juridiksionit të gjykatave të faktit. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë ka çmuar se pretendimet e paraqitura në rekurs nuk vinin në dyshim ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave më të ulëta.

22. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se, në rastin në shqyrtim, nuk rezulton që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të kenë përmbysur barrën e provës, duke ua ngarkuar kërkuarve detyrimin për të provuar pafajësinë e tyre, në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë. Përkundrazi, ato kanë identifikuar provat e paraqitura nga organi i akuzës, kanë analizuar përmbajtjen dhe lidhjen ndërmjet tyre, si dhe kanë arsyetuar në mënyrë të qartë dhe të plotë për fajësinë e kërkuarve, duke u mbështetur në një tërësi provash të administruara gjatë gjyqimit dhe jo vetëm në dëshminë e dëshmitarit okular, të cilat, të vlerësuara në tërësi dhe në ndërthurje me njëra-tjetrën, janë çmuar të mjaftueshme për të provuar akuzën përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Po kështu, gjykatat u kanë dhënë përgjigje edhe kundërshtimeve të kërkuarve për ligjshmërinë dhe vlerën provuese të dëshmisë së dëshmitarit okular. Gjithashtu, nuk rezulton që arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm në lidhje me vlerësimin e provave dhe përcaktimin e fakteve të përmbajë gabime të dukshme, kundërtënie ose elemente arbitrariteti, të një shkalle të tillë që ta bëjnë procesin të padrejtë në aspektin kushtetues. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuarve për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara.

23. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.